



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.235/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit J. H. sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/IL.nr .448/165 të dt.09.3.2016, për shkak të veprës penale: lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par 1 të KPRK-së., pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit J. H dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj me dt.29.5.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri J. H i lindur me dt.01.6.1984 në fsh. S e Th Komuna e P , , i biri i Sh dhe nënës K e gjinisë A, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës .

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 19.2.2015 , në kohë të pacaktuar , në fsh, Sferkë e thatë Komuna e Pejës , në shtëpinë tij , pa autorizim të furnizimit është lidhur në rrjetin elektrik , në atë mënyrë që i pandehuri me datën e lartcekur nga ana e komisionit të autorizuar të KEDS-it është hasur në kyçe të paautorizuar jashtë pikës matëse në KKK , një kabllo 1x10 mm² , e ku dërgonte 1-0-2 . me ç’ rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëme material.

fshin Sferkë

-me çka ka kryer vepra penale : lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 321 par 1 të KPRK-së.

E G J Y K O N :

- 1 Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Dhe :

Me dënim burgu,

- 2 Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro – 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.03.8.2015 kundër të pandehurit J. H ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.448/16, për vepër penale : lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par 1 të KPRK-së., duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.29.5.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .